



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –DRAGASH
OPSTINE DRAGAS
MUNICIPALITY OF DRAGAS



02 Nr. 320/01-11883/25
Datë: 18/06/2025
Dragash

Duke u bazuar ne shkresën e dërguar nga përfaqësues te Agjencisë te Ushqimit dhe Veterinarisë me nr. Referencë 03/2025 te datës 12.06.2025 lidhur me Marrja e masave parandaluese kundër përhapjes se sëmundjes PPR (Peste des Petits Ruminants) në zonat kufitare me Shqipërinë, Komuna e Dragashit:

NJOFTIM PËR FERMERËT E KOMUNËS SË DRAGASHIT

Të nderuar fermerë,

Ju njoftojmë se në territorin e Republikës së Shqipërisë është konstatuar shpërthimi i sëmundjes ngjitëse Murtaja e Kafshëve të Imta – Peste des Petits Ruminants (PPR), e cila prek kryesisht delet dhe dhitë.

Kjo sëmundje paraqet rrezik serioz për shëndetin e kafshëve dhe përhapet shpejt, prandaj kërkohet kujdes i shtuar dhe veprime të menjëhershme parandaluese nga ana juaj.

MASAT URGJENTE QË DUHET TË ZBATOHEN:

- Fermerët e komunës së Dragashit janë të obliguar të mos i lëvizin tufat e deleve në kullota afër territorit të Republikës së Shqipërisë, derisa situata të jetë nën kontroll.
- Nuk lejohet bashkimi i tufave të deleve nga Dragashi me tufat që vijnë nga territori i Republikës së Shqipërisë në kullosat verore.

Çdo rast i dyshimtë klinik, si dhe çdo lëvizje e pakontrolluar e kafshëve në zonën kufitare, duhet të raportohet menjëherë pranë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) apo autoriteteve komunale përkatëse në numrat kontaktues :

- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Tel: +383 38 20038324,
- Komuna e Dragashit-personat kontaktues: Inspektori komunal në Tel/mob: +38349745088 dhe Udhëheqësi i sektorit për bujqësi Tel/mob: +38344622121.

Veprimi juaj i shpejtë dhe përgjegjës është thelbësor për të mbrojtur tufat tuaja dhe për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të kësaj sëmundjeje ngjitëse në vendin tonë.



Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini